

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Wesley Clark: Mes shqiptarëve ndihem si në familje! Guximi juaj solli ndryshimin në vitin 1999
ADRESA	https://tpz.al/wesley-clark-mes-shqiptareve-ndihem-si-ne-familje-guximi-juaj-solli-ndryshimin-ne-vitin-1999-i333871
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 15:15:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 15:04:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bad23440fae388f519dda5023a4a80f92ab6022380085205cf4a76d3b1cbafd6
TEKSTI	77dc07d119a5fa03cc7f20240980932050feb1b29096fa019887fd8672041624
PAMJA	ac201cb468b3b9b5020e68605b5764fd24f7c023346a21e2194d066855a10886

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	90faacc99ba578e057da33b62eee057878aa928e7a381396b032875eb1043dfd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/90faacc99ba578e057da33b62eee057878aa928e7a381396b032875eb1043dfd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

15:34 Plagosje në Tiranë, 33 vjeçari shkon në spital me plagë të shaktuara nga arma e zjarrit • 15:15 "Dhunë fizike dhe fyerje"/ Rrëfimi i shefit të Komisarariatit të Krujës pasi €

AKTUALITET, 25 SEPTEMBER 2026, 17:04

Wesley Clark: Mes shqiptarëve ndihem si në familje! Guximi juaj solli ndryshimin në vitin 1999

tpz.al TPZ



Ish-gjenerali i NATO-s, Wesley Clark, foli për lidhjen e tij me shqiptarët, guximin e rezistencës në Kosovë dhe përvojat në Ruandë e Bosnje që ndikuan në vendosmërinë e tij për të mos lejuar përsëritjen e mizorive, gjatë mbrëmjes gala të organizuar në SHBA nga Këshilli për Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane. Në aktivitet, ku merr pjesë edhe kryeministri Edi Rama, Clark u nderua me një çmim.

Në fjalën e tij, ai tha se vlerësimi kishte një kuptim që shkonte përtej ceremonisë: ndjenjën se ishte pjesë e komunitetit shqiptar.

"Dua t'ju them thjesht se sa i nderuar jam që marr këtë çmim, por është më shumë se kaq: është të jesh pjesë e komunitetit tuaj. Sa herë që udhëtoj, kudo që shkoj, gjithmonë ka dikë nga Shqipëria. Ndiem si pjesë e familjes", u shpreh Clark.

Ai rrëfeu se shqiptarët e përshëndesin në restorante e aeroporte, në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara, duke i kujtuar Kosovën dhe shpesh duke këmbëngulur ta qerasin. Në një rast, tregoi ai, një burrë e kishte përshëndetur me thirrjen "UÇK", ndërsa në një tjetër kamerieri i kishte sjellë ëmbëlsirën me një përshëndetje për Kosovën.

Clark përmendi edhe një darkë në Café Milano, ku një person nga Kosova ishte afruar për ta takuar dhe kishte këmbëngulur që ai të mos paguante.

"Aty ishte dikush nga Kosova për të na përshëndetur dhe për të na thënë: 'Jo, jo, nuk mund ta paguani darkën. Nuk mund ta paguani darkën'", rrëfeu ai, duke shtuar me humor se më pas i kishin lënë kamerieres një bakshish të mirë.

Për Clark, këto takime janë edhe dëshmi e rëndësisë që ngjarjet e vitit 1999 vazhdojnë të kenë për shqiptarët.

"E di, sepse ju ma keni treguar, sa shumë do të thoshin për ju ato ngjarje të 1999-ës. Ato do të thonë shumë edhe për mua", tha ai.

ide!

Rikthimi i SHSH-it në politikë si banalitet
Nga Mero Baze

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë
Nga Preç Zogaj

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Duke iu kthyer nderynjes se NATO-s, Clark tregoi nje bisede me nje ambasadore te Kosoves, te cilës iu referua me emrin Flora, për organizimin e një darke përkujtimore më 24 mars. Ai e kishte pyetur përse ishte zgjedhur data e nisjes së bombardimeve dhe jo ajo e përfundimit të tyre në qershor.

[Shiko të tjera video](#)

"Ajo tha: 'Sepse kur dëgjova zhurmën e avionëve të NATO-s, e dija se do të shpëtoheshim'", kujtoi Clark.

Në vijim, ish-gjenerali vuri në qendër guximin dhe vendosmërinë e vetë shqiptarëve. Ai përmendi Adem Jasharin dhe njerëzit e parë që luftuan kundër dominimit serb në Kosovë, duke theksuar se ata paguan një çmim për lirinë që shumë njerëz në Perëndim e merrnin si të mirëqenë.

"Historia fillon me guxim. Fillon me guximin tuaj dhe vendosmërinë, me besimin në qytetërimin tuaj, gjuhën tuaj, kulturën tuaj, familjet tuaja", tha ai.

Clark ia atribuoi ndryshimet e asaj periudhe përkushtimit të njerëzve që rezistuan dhe u bëri thirrje të pranishmëve të ruanin kujtesën e unitetit që e bëri të mundur atë ndryshim.

"Ishte kuraja juaj, përkushtimi juaj që bëri të ndodhnin të gjitha këto ngjarje të vitit 1999. Jo imi, juaji", u shpreh ai.

Një pjesë të fjalimit Clark ia kushtoi klimës ndërkombëtare pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Ai kujtoi pasigurinë me të cilën ishte rritur brezi i tij, frikën nga përplasja bërthamore dhe ndryshimin e papritur që solli rënia e Murit të Berlinit. Sipas tij, vitet që pasuan u shoqëruan në Perëndim me besimin se demokracia, të drejtat e njeriut dhe liritë individuale kishin triumfuar.

Pikërisht në atë periudhë, tha Clark, guximi i njerëzve në Ballkan nxiti ndryshimin dhe gjeti mbështetje ndërkombëtare. Ai kujtoi angazhimin e paqeruajtësve në Kroaci e Bosnje, si dhe përpjekjet diplomatike të vitit 1995, kur ishte përfshirë në negociatë së bashku me Richard Holbrooke.

Clark tregoi se gjatë bisedimeve e kishin ngritur edhe çështjen e Kosovës me Slllobodan Millosheviçin, por ky i fundit kishte refuzuar ta diskutonte.

"Biseduam me Millosheviçin për Kosovën. Ai tha: 'Jo, ajo është imja. Nuk do të flas për këtë'", rrëfeu ai.

Në pjesën përmbyllëse të materialit, Clark foli për ndikimin që kishin pasur tek ai masakrat në Ruandë dhe dëshmitë për mizoritë në Bosnje. Ai tregoi se, kur shërbente në Pentagon, kishte hartuar një plan për ndërhyrje në Ruandë, por, sipas tij, propozimi ishte ndaluar nga eprori dhe nuk kishte mbërritur te presidenti Bill Clinton.

"Unë jetova me fajin e kësaj", tha Clark, duke e lidhur atë përvojë me vendosmërinë që ndjeu më pas përballë dhunës në Ballkan.

Ai kujtoi edhe tronditjen nga dëshmitë për torturimin e civilëve në Bosnje, përfshirë fëmijë. Clark tha se këto përvoja e kishin shtyrë të merrte një zotim personal: të vepronte sa herë të kishte mundësinë të ndalte mizori të tilla.

"I thashë vetes: Kurrë, kurrë, kurrë nuk do të lejoj të ndodhë diçka e tillë, nëse kam një shans ta ndal", u shpreh ai.

Zgjedhja e tre anëtarëve të rinj të KLGJ-së, mbledhja e përgjithshme: Të kemi kërkesa gjykata dinjitoze, nuk është luks

"Ky vend e tradhtoi Hashim Thaçin", Rama nga New York: SHBA nuk bëri më të mirën për "George Washington-in" e Kosovës

AKTUALITET / 25 September 2026, 16:30

Von der Leyen vjen të mërkurën në Tiranë, Presidentja e KE-së do të takohet me Ramën dhe Begajn

AKTUALITET / 25 September 2026, 15:55

PD depoziton propozimin për ndarjen e re territoriale: Shqipëria të ketë 100 bashki dhe 12 qarqe

AKTUALITET / 25 September 2026, 15:34

Plagosje në Tiranë, 33 vjeçari shkon në spital me plagë të shkaktuara nga arma e zjarrit

AKTUALITET / 25 September 2026, 15:15

"Dhunë fizike dhe fyerje"/ Rrëfimi i shefit të Komisarariatit të Krujës pasi e rrahën në rrugë

AKTUALITET / 25 September 2026, 15:07

Mbërrin në Shqipëri Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së, pritët t'i dorëzojë letrat kredenciale Presidentit Begaj

AKTUALITET / 25 September 2026, 14:45

Kthesa? Euro fiton papritur terren ndaj Lekut brenda javës

AKTUALITET / 25 September 2026, 14:32

Autori me dy armë në duar,
momenti i ekzekutimit të
Artan Myrtajt në Sarandë

AKTUALITET / 25 September 2026, 14:14

Skandalet, Këlliçi: Kanë rënë
të gjitha kolonat e shtetit,
Rama duhet të japë
dorëheqjen!

AKTUALITET / 25 September 2026, 13:57

Sarandë/ Zjarri shkrumbon
banesën, çifti i të moshuarve
përfundon në spital i
asfiksuar, ja si paraqitet
gjendja e tyre!

AKTUALITET / 25 September 2026, 13:52

Detaje të reja/ "Ata janë më të
fortë në lagje", sherri mes të
miturve nisi në Tik Tok, si ra
në gjurmët e tyre policia

AKTUALITET / 25 September 2026, 13:43

Axhenda e 29 shtatorit/
Këshilli Bashkiak i Tiranës
fton Veliajn në mbledhje,
kërkesë SPAK-ut e Burgjeve
për pjesëmarrjen

AKTUALITET / 25 September 2026, 13:34

Parandalohet konflikti/ Gati
për sherr me shkopa bejsbolli
në Yzberisht, policia ndërhyr
në kohë! Shoqërohen 23 të
mitur

AKTUALITET / 25 September 2026, 13:26

"Territorialja"/ Këshilli
Bashkiak i Shkodrës jep
pëlqimin! PD voton kundër,
debate edhe për statusin e
Dukagjinit dhe Velipojës

AKTUALITET / 25 September 2026, 13:18

'Begaj të japë llogari'/
Mbledhja e Këshillit të
Sigurisë, Bardhi: Shqiptarët
nuk kanë nevojë për
spektakël institucional!

AKTUALITET / 25 September 2026, 13:12

Nju Jork/ Balla takohet me ish-gjeneralin e NATO-s, Clark: Dy herë mirënjohje për këtë burrë të veçantë, për mbrojtjen e Kosovës dhe dëshminë në Hagë!

AKTUALITET / 25 September 2026, 13:03

Vendimi/ Anulohet tenderi 4.59 mld lekë për hemodializën në 5 qytete, APP: Gabime dhe mangësi në dokumente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.